

Nuk është dhuratë nga Zoti

KUR FIKESHIN DRITAT

Ata mendonin
Se çdo mbrëmje
Në orën 6
Kur fillonte ora policore
Ne do të strukeshim
Si minjtë nëpër bodrume
E do të na rrokte
Një gjumë i rëndë
E do të flenim
E do të flenim
E do të flenim
E kurrë më
Nuk do ta shihnim hënën
E kurrë më
Nuk do ta shihnim diellin

Por ne
Çdo mbrëmje
Në orën 6
E mbyllim derën me dry
Errësirën e lenim përjashta
Tuboheshim rreth zjarrit
Pinim qumësht të nxehtë Kosovë
Lexonim e këndonim
Bënim shaka e bënim plane
Qëndsinim një ardhmëri
Të ngrohtë si zjarr
Të bardhë si qumështi i Kosovës.

PA TY

Sot nuk po qaj për ty
Po qaj për nipat e mbesat
Që kurrë nuk do t'i njohësh
Për lulet që nuk do t'i shohësh

Për vendin e zbrazët në tavolinë
Për përparësen tënde në kuzhinë
Për telefonin që pluhuri do ta mbulojë
Për hijet e kumbullave ku pa ty më s'shkoj

Për dasmat ku vallja jote mungon
Për muret ku qeshja jote më nuk kumbon
Për rezet e para të mëngjesit që ti s'i përshëndet
Për dorën e plasarit që rreth qafe nuk ma qet

Për zërin tënd kur më ngujon nata
Për akulloret nëpër promenada
Për gëzimin tënd në aeroport
Për duart që shtrëngoheshin aq fort

Për pasaportën tënde pa vula, pa kujtime
Për këngët e reja, për festat pa urime

KUR TA SHES SHTËPINË

Kur ta shes shtëpinë
Oborrin do ta marr me vete
Se do të më marrë malli
Për hapat tu të lehtë

Kur ta shes shtëpinë
Dritaret do t'i marr me vete
Që ta kujtoj fytirën tënde të buzëqeshur
Kur kthehesha nga puna

Kur ta shes shtëpinë
Muret do t'i marr me vete
Që ta dëgjoj kumbimin
E zërit tënd të hareshëm

SYTË E MI

Bija ime
Sytë e mi
Janë shkolla jote

Nga MERITA PERVETICA - LUMLEY



Merita Përvetica - Lumley u lind në fshatin Breznicë. Që nga viti 1992 jeton në Angli, ku ka kryer fakultetin juridik, studimet postdiplomike në drejtësi dhe ka magjistruar në psikoterapi. Momentalisht punon si këshilltare në Ministrinë e Qeverisë Lokale në Londër. Para se të emigronte, botoi artikuj, tregime e poezi nëpër gazeta e revista Kosovare. Fitoi çmimin e parë për poezi në konkursin letrar gjithëkombëtar 2011 "Flaka e Janarit". Ka botuar dy libra me poezi.

Në sytë e mi
Ti mëson fizikë dhe
Llogarit peshen e mikut
Dhe të armikut

Në sytë e mi ti
Mëson edhe matematikë
Bën zbritjen
Dhe shumëzimin e dëshirave

Në sytë e mi
Ti mëson histori
Fotokopjon gabimet dhe fitoret
Për provimet që ke nesër

Në sytë e mi ti
Mëson edhe gjeografi
Kërkon shtigje të reja
Në hartën e ardhmërisë

Në sytë e mi ti
Mëson edhe muzikë
Këndon për dashurinë
Dhe lexon vetminë

Nganjëherë
Tërë natën nuk më zë gjumi
Kam frikë se të tradhetojnë sytë e mi

FRYMËMARRJE

Frymëmarrja është art, bija ime
Nuk trashëgohet prej prindërve
Nuk është dhuratë nga Zoti

Mësohu të marrësh frymë, zemër
Mbushi mushkëritë me ngjyrtarë e agimit
Me fluturimin e dallëndysëve
Me vesën e trëndafilave
Me gjirin e ngrohtë të nënës
Me valët lozonjare të detit

Thith ëndrra të bujshme
Nën retë e botës së vjetër
Mbush shpirtin me ritmin e stinëve

Me respekt për tokën, ujin dhe yjet
Me dashurinë për njerëzit

Merr frymë, bija ime, merr frymë
Por jo shpejt, se mos harron lojën
Por jo ngadalë, se të përbin harrësia

Por jo thellë, se të vret liria
Por jo cekët, se tretet dashuria

Por jo poshtë, se të verbon zilia
Por jo lart, se të çmend fuqia

Frymëmarrja është art
Piktorja ime e vockël
Bota është gati për brushën dhe dorën tënde

DO TË MBETEN VETËM KUJTIMET

Princesha ime
Një ditë edhe ti do të rritesh
Dora jote do të shkëputet e largohet
Nga dora ime

Po vallë a do ta mbajë mend pasqyra
Buzëqeshjen tënde diellore?

A do t'u kujtohet mureve
Jehona e këngëve tua?

Oborri a do ta mbajë mend
Vogëlushen këmbëzbathur
Hapat tu të lehtë dhe
Piten prej balte
Gjunjtë e gërvishur
Topin me pika
Dordolecin tënd të parë

Qiellit a do t'i kujtohet
Hunda jote e vockël
E ndrydhur në dritare
Derisa pret prindërit të kthehen nga puna?

Mëngjesit a do t'i kujtohet zëri yt i përgjumur

Dhe përqafimet tona të ngrohta?

Vogëlushja ime e ëmbël
Dashurinë merre me vete
E mua do të më mbeten vetëm kujtimet

KUR MA KTHEN SHPINËN

Nganjëherë
Kur ndahemi në oborr të shkollës
Unë numëroj orët e ngadalshme
Mes puthjeve e përqafimeve tona.

Të shikoj derisa largohesh
Me çantë në shpinë
E më shkon mendja
Te gjithë ato nëna shqiptare
Që kështu kanë shikuar bijtë e bijat e tyre
Duke u larguar
Me çanta në shpinë

I kanë shikuar e shikuar
E janë munduar
Të mos trahin çerpikë
Derisa fëmijët e tyre i ka përpirë
Pluhuri e errësira
E nuk e kanë ditur
A do t'i shohim më
Gjallë a vdekur

AH, SIKUR T'ISHA MBUROJA JOTE!

Më shikon
E heshtur
Me çerpikë të lagët
Me gjurmë lotësh
Në faqet tua të njoma

Marr gjilpërat
Që ma therrin zemrën
E mendohem
Gëzimin tënd ta harrnoj

Botën dua ta laj
Derisa të vezullojë nga pastërtia
E pastaj ty të ta jap dhuratë
Vogëlushja ime
Të mbushur me gëzime.

LAMTUMIRË

Foshnja ime
E ëmbla, e vockëla e mami
Sonte do të fle pa ty
Sonte do të na ndajnë përgjithmonë

Shtëpia do të heshtë
Si varri yt

Lodrat tua
Do të struken në një qoshe
E do të më shikojnë
Herë me pikëllim
Herë me frikë

Shtrati im dhe jastëku yt i ftohtë
Tërë natën do të m'i përtypin
Eshtrat, zemrën, barkun dhe shpresat
Do të m'i përtypin ëndrrat
E në mëngjes do të më pështyjnë
Si kafshatë të hidhur

Do të zvarritem deri të dritarja
E do ta lus diellin
Të më verbojë
Që kurrë më të mos e shoh kopshin
Ku këmbët tua të vockëla
Nuk vrapuan kurrë